



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:196528  
Datë: 04.09.2024  
Numri i dokumentit: 06123301

**Ac.nr.6288/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Hysni Bardheci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a., me seli në Prishtinë, Rr. “Nënë Tereza”, kundër debitorit Sh.K. nga Suhareka, me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, PP.nr.506/21 të datës 10.08.2022, me datë 04.09.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore Prizren-Dega në Suharekë, PP.nr.506/21 i datës 10.08.2022, dhe gjykohet si në vijim: **REFUZOHET** i pabazuar prapësimi i debitorit Sh.K. nga Suhareka, i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.78/20 të datës 31.01.2020, dhe mbetet në fuqi urdhri P.nr.78/20 i datës 31.01.2020, i lejuar nga përmbartuesi privat Rushit Hoxha, në Prizren.

**A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, me aktvendimin e atakuar PP.nr.509/21 të datës 10.08.2022, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht si i bazuar prapësimin e debitorit Sh.Z.K. nga Suhareka, i dt.10.02.2020, i parashtruar kundër P.nr.78/20 të dt.31.01.2020, të lejuar nga zyra e përmbartuesit privat Rushit Hoxha nga Prizreni, në shumën prej 2904 euro, dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor, për shumën e lartcekur. Në pikën II, ka refuzuar pjesa tjetër e prapësimit e debitorit për shumën prej 285 euro, dhe ka detyruar të njëjtin që këtë shumë t’ia paguaj palës kreditore me kamat prej 8% që nga parashtrimi i propozimit përmbartimor. Në pikën III, ka vendosur që shpenzimet e procedurës përmbartimore bien mbi palën debitore.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të pranoj si të bazuar ankesën e kreditorit, ashtu që të ndryshoj aktvendimin e atakuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim P.nr.78/20, ose të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur debitori.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datë 31.01.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit nga librat e afariste DPZ-9040180, lidhur me borxhin e krijuar për konsumin e energjisë elektrike në vlerë prej 3,189.83 euro, për periudhën kohore nga data 14.01.2013 e deri me datën 20.03.2013. Përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin me urdhrin P.nr.78/20 i datës 31.01.2020, ndaj të cilit urdhër debitori ka ushtruar prapësim me datë 10.02.2020, ndërsa kreditori ka ushtruar përgjigje në prapësim me datë 13.02.2020.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin PP.nr.14/2020 të datës 09.03.2020, ka pranuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbarimor P.nr.78/2020, i datës 31.01.2020, i lëshuar nga përmbaruesi privat, ka mbetur në fuqi pjesërisht dhe atë vetëm për shumën prej 285.73 euro (vetëm për 5 keste të papaguara) si dhe për shpenzimet për lejimin e përmbarimit. Kundër këtij aktvendimi, debitori ka paraqitur ankesë e cila është aprovuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin Ac.nr.2598/2020 të datës 19.08.2021, duke e kthyer çështjen në rivendosje në gjykatën e shkallë së parë.

Në rivendosje, gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimit dhe përgjigjes në prapësim ka marr aktvendimin e atakuar duke aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit duke anuluar urdhrin përmbarimor për shumën prej 2,904.00 euro, ndërsa është refuzuar pjesa tjetër e prapësimit të debitorit në shumën prej 285.00 euro, dhe është detyruar debitori që këtë shumë t'ia paguaj kreditorit me kamatë prej 8% që nga parashtrimi i propozimit për përmbarim, si dhe shpenzimet e përmbarimit.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata e shkallës së parë ka konstatuar pjesërisht si të bazuar prapësimi i debitorit, në shumën prej 2904 euro, për faktin se kjo shumë është kumulative, nuk është përfshirë saktë periudha se si ka ardhur deri tek kjo shumë, duke e tejkaluar shumën e paguar konform kontratës me numër 55583, ku pala debitore ka kryer 13 këste të pagesave,

ndërsa pjesa refuzuese ka të bëjë me borxhin e përgjithshëm prej vitit 2010 e deri në vitin 2019 dhe se borxhi i kërkuar sipas propozimit përbarimor bie ndesh me vet propozimin e kreditorit për faktin se në propozimin përbarimor kërkohet detyrimi për periudhën prej datës 14.01.2013 deri më 20.03.2013, ku siç shihet për periudhën për të cilën kërkohet detyrimi i pagesës, pala debitore më shumë ka kryer pagesa për energjinë e shpenzuar se sa është faturuar. Ndërsa si në pikën e dytë të dispozitivit gjykata është bazuar në provat e bashkangjitura ku palët ndërgjyqëse kanë lidhur Kontratën me numër 55583, për pagesën e borxhit në shumë prej 981.73, ku si pjesë e saj ka qenë edhe deklarata mbi dakordimin e borxhit me numër 55583, ku janë paraparë 18 këste të pagesave, ndërsa nga ekstrakti DPZ-9040180 i datës 31.01.2020, ka konstatuar se pala debitore ka kryer 13 këste të pagesave me nga 58 euro, ndërsa shuma e mbetur e pa paguar sipas kontratës së lartcekur, është shuma prej 285.73 euro, ku për këtë pjesë të detyrimit të debitorit ndaj kreditorit pasi që me lidhjen e kontratës për borxhin, është ndërprerë parashkrimi për pjesën e detyrimit të kontraktuar. Tutje gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se pas lidhjes së kontratës dhe përmbushjes së saj në pjesën dërmuese, pala kreditore ka mundur që palës debitore t'ia ofrojë një afat shtesë para se ta inicion procedurën përbarimore, ndërsa në rastin konkret nuk ka asnjë komunikim të palëve me shkrim se palët a qëndrojnë pranë kontratës apo kërkojnë shkëputjen e saj. Ndërsa sipas nenit të LMD-s parashihet se “Kreditori mund ta zgjidhë kontratën pa i lënë debitorit afat të ri për përmbushjen e detyrimit në qoftë se nga qëndrimi i debitorit del se ai detyrimin e tij nuk do ta përmbushë as në afatin e ri”. Ndërsa, sipas nenit 113 të LMD-s, theksohet fakti se “Kontrata nuk mund të zgjidhet për shkak të mos përmbushjes së pjesës me vlerë të vogël të detyrimit”. Ndërsa lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur konform nenit 13 të LPP-së

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktvendimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, mirëpo sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se prapësimi i debitorit është tërësisht i pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktvendimi i atakuar të ndryshohet konform nenit 201 pika b) dhe d) të LPK-së, ndërsa si rezultat i kësaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit qëndron pretendimi ankimor i kreditorit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në vlerësimin e gabuar të provave që kanë dërguar në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Kjo pasi që nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, shihet se kreditori dhe debitori, me datë 10.07.2017 kanë lidhur kontratën për pagesën e borxhit, të cilës i është bashkangjitur edhe deklarata mbi dakordimin e borxhit nr.55583, me çka debitori e ka pranuar borxhin total prej 3,943.83 euro, dhe ka arritur

marrëveshje me kreditorin që të bëjë pagesën e borxhit në shumë prej 1,039.73 euro, në 18 këste sipas programit të pagesës së borxhit, me qëllim që të përfitojë faljen e borxhit të grumbulluar deri më datë 31.12.2008, në shumë prej 2,904.10 euro, konform Ligjit Nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike. Mirëpo, meqenëse debitori nuk e ka bërë pagesën e pesë kësteve të fundit sipas marrëveshjes së lidhur, kreditori duke vepruar konform nenit 3 të kontratës ku parashihet se “Në rast se përfituesi shkakton 3 pagesa të njëpasnjëshme lidhur me pagesat sipas Programit, marrëveshja shkëputet dhe pjesa e pa paguar e borxhit, nëse ka, fshihet dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet, përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet”, i ka rikthyer debitorit të gjithë borxhin e vjetër, duke i zbritur vlerën e pagesave të bëra, ashtu që tani kreditori ka kërkuar borxhin në shumë prej 3,189.83 euro.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, kreditori me të drejtë i ka rikthyer borxhin debitorit, ngase nga ekstrakti i verifikuar nga librat afariste DPZ-9040180, rezulton se debitori ka paguar 13 këste nga 18 sa ishin të parapara me kontratë për pagesën e borxhit, ku debitori është obliguar që këtë borxh t’ia paguaj kreditorit dhe atë këstin e fundit me datën 11.05.2020, ndërsa duke pasur parasysh faktin se debitori nuk ka paguar këstet siç ishte përcaktuar me deklaratën për dakordimin e borxhit, rezulton se i njëjti ka shkaktuar tre (3) vonesa të njëpasnjëshme. Andaj, duke u bazuar në nenin 3 të kontratës për pagesën e borxhit, kreditori me të drejtë ka bërë rikthimin e borxhit duke i zbritur vlerën e pagesave të bëra nga debitori. Për me tepër, edhe në bazë të nenit 6 paragrafi 3 të Ligjit për Faljen e Borxheve Publike, përcaktohet se: *“Pavarësisht dispozitave të nenit 4 të këtij ligji, nëse personat të cilët përfitojnë nga ky ligj përmes arritjes së marrëveshjes për pagesën me këste të obligimeve për periudhën 1 janar 2009 deri 31 dhjetor 2014, dështojnë në respektimin e kushteve të marrëveshjes, atëherë, Institucioni Shtetëror apo Ndërmarrja Publike ka përgjegjësi që të njëjtin ta vendosë në listën e borxheve, duke e bërë obligues për të gjitha borxhet e mbetura sipas kërkesave ligjore që kanë qenë të zbatueshme para lidhjes së marrëveshjes”*.

Në bazë të nenit 29 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore është paraparë së *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Ndërsa sipas paragrafit 3 të këtij neni është paraparë së *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në rastin konkret përmbartimi është caktuar në bazë të Ekstraktit nga librat afarist DPZ-9040180, i cili bazuar në dispozitat e lartcekura është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim. Kjo pasi që në bazë të këtij ekstrakti rezulton se kreditori pas dështimit të debitorit në pagesën e me shumë së tre kësteve duke u bazuar në kontratën për faljen e borxhit ka bërë rikthimin e borxhit duke i zbritur vlerën e pagesave (kësteve) të bëra nga debitori, ashtu që tani kreditori ka kërkuar borxhin në shumë prej 3,189.83 euro. Gjykata e Apelit, gjeti së shuma e kërkuar nga kreditori pasqyrohet në ekstraktin nga librat afarist, në perudhën për të cilën kreditori e ka kërkuar borxhin, dhe kjo gjykatë vlerëson së përmbartuesi privat me të drejtë ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit, andaj vendosi që

aktvendimin e atakuar ta ndryshoj, duke e refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor P.nr.78/20 i datës 31.01.2020.

Lidhur me pretendimin e debitorit të paraqitur në prapësim së kërkesa e kreditorit është parashkruar, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim është i pabazuar. Kjo pasi që sipas dispozitës së nenit 368 paragrafi 1 të LMD-së shprehimisht përcaktohet se: *“Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin”*, ndërsa me paragrafin 2 përcaktohet se: *“Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Në kuptim të kësaj dispozite Gjykata e Apelit, gjeti së kreditori dhe debitori, me datën 10.07.2017, kanë lidhur kontratën për pagesën e borxhit, të cilës i është bashkangjitur edhe deklarata mbi dakordimin e borxhit, e cila ka ndikuar në ndërprerjen e parashkrimit, pasi që me këtë kontratë debitori e ka pranuar borxhin total prej 3,943.83 euro. Në bazë të nenit 373 par.2 të LMD-së, është paraparë së *“Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimi (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi)”*. Në rastin konkret në bazë të ekstraktit të verifikuar nga librat afariste (transaksioni i konsumatorit) rezulton së debitori këstin e 13, në vlerë prej 58.00 euro e ka paguar me datë 19.06.2019, ndërsa kreditori prozimin për përmbarim e ka paraqitur me datë 31.01.2020, çka rezulton së nuk ka kaluar afati prej një viti në mënyrë që kërkesa e kreditorit të përfshihet në parashkrim.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika c), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6288/2022, datë 04.09.2024

Gjyqtari,  
Hysni Bardheci